

# SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE, SHOQËRISË "NATIONAL" SHA TIRANË

Për ushtrimin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2021

## TË PËRGJITHËSHME DHE POLITIKAT KONTABEL

Shoqëria "NATIONAL" SHA, u regjistrua si biznes në datë 23/01/2018 me administrator Znj. Nekilda Sulaj, me objekt veprimtarie: Ushtrimin e veprimtarise se lojrave te fatit dhe perkatesisht "Bingo Televizive", "Baste Sportive dhe "Baste per Garat ne Piste", etj.

Kjo shoqëri është regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT: L81323029B .

## MBI POLITIKAT KRYESORE TËKONTABILITETIT

Pasqyrat financiare më 31 Dhjetor 2021 janë përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe të ligjit 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin e pasqyrat financiare"

Kontabiliteti i shoqërisë "NATIONAL" SHA, është i organizuar rregullisht, i mbështetur mbi sistemin manual të mbajtjes të kontabilitetit, si dhe ata të informatizuar të cilat mundësojnë jo vetëm regjistrimin e të dhënave por dhe marrjen e informacionit, respekton të gjitha kërkesat e Planit Kontabël, ligjin mbi Kontabilitetin dhe kërkesat e tjera ligjore. Llogaritë e ushtrimit financiar të vitit 2021 janë hartuar me hipotezën e vijueshmërisë dhe janë zbatuar vlerësimet e parashikuara në këtë situatë.

Monedha në të cilën shprehen të gjitha pasqyrat financiare është leku shqiptar pa bërë rrumbullakime.

## VLERËSIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Efikasiteti i kontrollit të brendshëm është i lidhur me sigurimin e mbrojtjes së pasurisë nga cdo lloj dëmtimi e shpërdorimi dhe në të njëjtën kohë të sigurojë besnikërinë e informacionit administrativ, kontabël e financiar duke qenë i besueshëm nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhur edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga ndarja e punës, verifikimet dhe deri tek informimet, veprime këto që përgjithësisht në Entitet janë realizuar.

## SHËNIME MBI ZËRAT E LLOGARIVE NË PASQYRAT FINANCIARE

### AKTIVI AKTIVET MONETARE

Në këtë pozicion të bilancit janë pasqyruar, aktivet monetare në vlerën **25,506,318 lekë**, përcaktuar në llogaritë në arkë dhe në bankë. Ka vijueshmëri në regjistrimin e dokumentave, përsa i takon datave dhe ka dokumenta justifikuese për veprimet e kryera. Diferenca e likuiditeteve për vlerën **-5,494,509 lekë**, e pasqyruar drejt në pasqyrën e fluksit monetar bashkangjitur bilancit, përputhet me pasqyrimin e tyre në aktiv të bilancit.



Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2018	25,506,318 lekë
Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2020	20,011,809 lekë
Diferenca	<u>-5,494,509 lekë</u>

### AKTIVE TË TJERA FINANCIARE AFATSHKURTËRA

Kërkesa të arkëtueshme në vlerën 37,500,000 lekë ku përfshihen: llog 4562 "Kapital i nenshkruar i papaguar" ne vleren 37.500.000 leke.

### SHPENZIME TE SHTYRA

Shpenzime te shtyra ne vleren 4,584,585 leke nga llogaria 486 "Shpenzime te periudhave te ardhme".

### INVENTARI

Inventari për vlerën 0 lekë

### AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktive të tjera afatgjata materiale me vlerë kontabël për vlerën 39,299,073 leke ku përfshihen llogarite: 215 Mjete transporti", llog 2188 "Te tjera AA materiale", llogaria 2182 "Pajisje informative"

### PASIVI

### HUATË E PARAPAGIMEVE

Për vitin ushtrimor 2021 detyrimet në total janë në vlerën 48,957,305 lekë që në mënyrë analitike janë si më poshtë :

Detyrimet afatshkurtra me vlerë totale 34,505,901 lekë, ku përfshihen:

Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit, llogaria 401 "Llogari të pagueshme" në vlerën 14,697,911 lekë.

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 11,690,200 lekë, ku përfshihet: llogaria 421 "Paga dhe shpërblime" dhe llogaria 431 "Sigurime shoqërore dhe shëndetësore".

Të pagueshme për detyrimet tatimore në vlerën 5,827,781 lekë, ku përfshihet llogaria 442 "Tatim mbi te ardhurat personale" 22,750 leke, llogaria 444 "Tatim fitimi" 70,573 leke, llogaria 449 "Tatim ne burim" 48,750 leke dhe llogaria 447 "Te tjera tatime per tu paguar" ne vleren 5,685,708 leke.

Detyrimet afatgjata me vlerë totale 14,451,314 lekë, ku përfshihet llogaria 460 "Qera financiare" dhe llog 419 "Parapagime te marra"



## KAPITALI

Gjendja e llogarive te Kapitalit dhe Rezervave të Shoqërisë në përfundim të periudhës është në vlerën 52,438,161 leke dhe përbëhet nga Kapitali i nënshkruar 50,000,000 lekë, Fitimi i pashperndare ne vleren 1,238,378 leke dhe Fitimi i vitit ushtrimor 2021, marrë nga PASH me 1,199,784 lekë.

### PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin 2021 Shoqëria "NATIONAL" SHA ka realizuar shpenzime në masën 119,197,337 lekë nga veprimtaria e shfrytëzimit. Shpenzimet janë si më poshtë:

**Mallra lendet e para dhe shërbime 991,379 lekë** ku përfshihen llog 605 "Blerje /shpenz te mallra, shërbimesh".

**Shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit 104,359,635 lekë** ku përfshihen: llogaria 611 "Trajtime te pergjithshme", llog 616 "Sigurime"; llogaria 618 "Të tjera"; llog 626 " Shpenz postare dhe telekom", llog 634 "Taksa dhe tarifa vendore" dhe llogaria 658 "Shpenzime të tjera " llog 657 "Gjoha dhe demshperblime"etj.

**Paga në vlerën 11,172,481 lekë** ku përfshihet 641 "Pagat dhe shpërblimet e personelit"

**Shpenzimet e sigurimeve shoqërore për 1,865,811 lekë** ku përfshihet llog 644 " Sigurimet shoqerore dhe shendetësore".

**Shpenzime tatim fitimi ne vleren 301,500 leke** nga llogaria 694 "Tatime mbi fitimet".

**Shpenzimet financiare ne vleren 506,531 leke përfshijnë:** Llogaria 628 "Shërbime bankare"dhe llogaria "Shpenzime per interesa"

### MBI TË ARDHURAT

Shoqëria ka realizuar të ardhura në masën 120,397,180 lekë nga veprimtaria e shfrytëzimit ku përfshihet:

**Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit ne vleren 120,164,399 ku përfshihen:**

llogaria 704 "Shitje e punimeve dhe shërbimeve" ne vleren 118,693,230 leke si dhe llogaria 7088 "Te tjera" ne vleren 1,471,109 leke.

Shoqëria deklaron edhe te ardhura financiare nga diferencat pozitive te kurseve te kembimit ne shumen 232,781 leke.

### PËRLLOGARITJA E TATIM FITIMIT

FITIM/(HUMBJA) E USHTRIMIT	1,501,284
SHPENZIME TE PANJOHURA	508,716
TATIM FITIMI (15%).	301,500
FITIM/(HUMBJA) TATIMORE	1,199,784

### PASQYRA E FLUKSIT TË PARAVE-Metoda Indirekte



Eshtë ndërtuar nga ana e jonë në përputhje me standartet kombëtare të kontabilitetit, bazuar në levizjet e mjeteve monetare të shoqërisë sipas kërkesave që ka vetë pasqyra dhe në perfundim rezulton:

Mjete monetare në fillim	25,506,318 lekë
Mjete monetare në fund të periudhës	20,011,809 lekë
Rritja/renia neto e mjeteve monetare	-5,494,509 lekë

Pra, ka përputhje të plote të pasqyrës të fluksit monetar dhe gjendjes të aktiveve monetare të vendosura në aktiv të bilancit.

### PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Eshtë plotësuar sipas kërkesave duke patur parasysh të gjitha ndryshimet e kryera gjatë periudhës ushtrimore dhe ku gjëndja e këtyre kapitaleve të vet shoqërisë në fund të periudhës paraqitet me një vlerë prej 52,438,161 lekë e cila paraqitet si në pasqyrën e ndryshimit të kapitaleve, po ashtu edhe në postin e kapitaleve në pasiv të bilancit 2021.

### SHËNIME TË TJERA SHPJEGUESE

Ngjarje të tjera të ndodhura pas datës të bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës të bilancit që nuk bëhen rregullime, nuk ka.

Duke patur parasysh shënimet e mësipërme, paraqitim të gjitha aspektet, të gjendjes financiare të shoqërisë deri më 31.12.2021.

Tiranë , më 31.03.2022

Administratori

Nekilda Sulaj

*Nekilda Sulaj*

